



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:285939

Datë: 20.03.2023

Numri i dokumentit: 04100109

Pml.nr.106/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKAT SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare, Rasim Rasimi dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit B. M. për shkak të të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit av. Bajram Zogiani nga Fushë Kosova, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.669/2022 të datës 27.1.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PNI.nr.140/2023 të datës 9.2.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20.3.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit B. M., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.669/2022 të datës 27.1.2023 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PNI.nr.140/2023 të datës 9.2.2023, ashtu që të pandehurit B. M., masa e paraburgimit i zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak, e cila masë do t'i zgjasë deri më datën 26.3.2023.

II. I pandehuri nuk guxon të largohet nga shtëpia – banesa e tij e ku jeton në Fushë Kosovë, rruga “... ..”, objekti, hyrja kati, nr., përveç me leje të posaçme të gjykatës.

III. Gjykata mund të caktojë masën e paraburgimit nëse i pandehuri nuk e respekton këtë aktgjykim.

IV. Stacioni Policor në Fushë Kosovë detyrohet që të bëjë zbatimin, mbikëqyrjen dhe verifikimin e masës së arrestit shtëpiak për të pandehurin.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.669/2022 të datës 27.1.2023, të pandehurit B. M., për shkak të të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi të pandehurit do t'i zgjasë deri me datën 26.3.2023. Të pandehurit masa e paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 e 1.2.3 të KPPK.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1.nr.140/2023 të datës 9.2.2023 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit B. M. av. Bajram Zogiani, për shkak të vazhdimit të paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar, aktvendimet e kundërshtuara t'i ndryshojë ashtu që të pandehurin ta lirojë nga paraburgimi.

Kryeprokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.III.nr.46/2023 e datës 17.3.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjës në kërkesë dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit konsideron se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë rrethana që e bëjnë të arsyeshëm vazhdimin e paraburgimit, paraburgimi të pandehurit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 187 par.1 e 2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, por nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë rrethana që paraqesin rrezik që të ndikojë në dëshmitarë e as që mund ta përsërisë veprën penale, ngase i pandehuri është përdorues i substancave narkotike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet e mbrojtësit sa i përket shqiptimit të masës më të butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë të bazuara. Në fakt, nga shkresat e lëndës, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryes i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se vazhdojnë të qëndrojnë bazat ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1 e 2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, duke marr parasysh faktin se hetimet ende vazhdojnë por mundësia e ndikimit është inferiore si dhe nuk ka rrezik evident të përsëritjes së veprës penale sepse nuk ekzistojnë rrethanat konkrete që e arsyetojnë këtë rrezik.

Kjo Gjykatë vlerëson se edhe me masën e arrestit shtëpiak mund të sigurohet prania e tij në procedurë, prandaj masën e paraburgimit e zëvendësoi me masën e arrestit shtëpiak konform dispozitës së nenit 181 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1 e 2 pika 1.2.3 të KPP. Masa e paraburgimit konform nenit 187 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3

të KPP vazhdohet, në rastin konkret vazhdohet vetëm nëse asnjë nga masat alternative nuk mund të jenë efektive në aspektin e parandalimit të përsëritjes së veprës penale dhe zhvillimit të pa penguar të procesit penal e që një situatë e tillë në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk ekziston.

I pandehuri nuk guxon të largohet nga banesa e tij, ku e ka vendbanimin, përveç kur kjo është domosdo e nevojshme për përmbushjen e nevojave jetësore dhe vetëm me lejen e gjykatës. Gjykata mund ta caktojë masën e paraburgimit në rast se i pandehuri e shkel pa lejen e gjykatës këtë masë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 438 par.1 nën par. 1.1 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.106/2023, më 20 mars 2023

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj